



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 57-17/2019 regjistër (JR)
Datë 24.04.2023

Nr. 18 i vendimit
Datë 08.05.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 08.05.2025, ditën e enjte, në orën 15:10, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar z. Ferdinando Buatier De Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdini, çështjen që i përket:

KËRKUES:	Alfred Gjoni, lindur e banues në Tiranë, përfaqësuar ¹ nga avokat Ardian Visha me nr. licence {***}, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë.
OBJEKTI:	Rishikimin e vendimit nr. 9 (JR), datë 26.06.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 9 (JR), datë 26.06.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.
BAZA LIGJORE:	Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 494-501 të Kodit të Procedurës Civile.

¹ Me prokurën e posaçme nr. {***} rep., dhe nr. kol. {***}, datë 17.04.2023.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, shqyrtoi pretendimet e kërkuarit në kërkesën e paraqitur prej tij dhe parashtrimet me shkrim, i cili përfundimisht kërkoj rishikimin e vendimit të Kolegjit nr. 9 (JR), datë 26.06.2020, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Z. Alfred Gjoni (në vijim “kërkuesi”), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, sipas përcaktimeve të nenit 179/b të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”). Pas hetimit administrativ të zhvilluar, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 100, datë 14.01.2019, ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Alfred Gjoni, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Kërkuesi e ka kundërshtuar këtë vendim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), i cili, pas shqyrtimit të ankimit të paraqitur, me vendimin nr. 9 (JR), datë 26.06.2020, vendosi lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
2. Në vendimin nr. 9 (JR), datë 26.06.2020, trupi gjykues i Kolegjit, pasi shqyrtoi ankimin kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nëpërmjet të cilit është marrë masa disiplinore e shkarkimit nga detyra [vendimi nr. 100, datë 14.01.2019], vlerësoi se është i drejtë dhe, për rrjedhojë, është lënë në fuqi. Trupi gjykues i Kolegjit e ka mbështetur këtë konkluzion në kontrollin e të tria kritereve dhe në vlerësimin tërësor të procedurave të rivlerësimit, duke konstatuar se “subjekti i rivlerësimit Alfred Gjoni gjendet në kushtet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit D dhe pika 4 e nenit E të Aneksit të Kushtetutës, si edhe nga pikat 3, 4 e 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016”.
3. Kërkuesi ka paraqitur në Kolegji kërkesë për rishikimin e vendimit të mësipërm të Kolegjit, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon.

3.1. Më datë 21.03.2023 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ka lënë në fuqi vendimin nr. {***}, datë 01.12.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe vendimin nr. {***}, datë 08.03.2021 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të cilat kanë disponuar për deklarimin fajtor të të pandehurit L. D. për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186, paragrafi i parë i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim. Kërkuesi sqaron se nga përmbajtja e arsyetimit të vendimit të deklarimit fajtor, rezulton se z. D. ka përfituar në mënyrë të paligjshme, në cilësinë e gjyqtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, nëpërmjet falsifikimit të dokumenteve. Më tej kërkuesi shpjegon se realiteti i të dhënave mbi *curriculum*-in e tij do të pamundësonte zgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarit L. D. në një organ

kushtetues, siç është Kolegji i Posaçëm i Apelimit. Për këtë rrethanë të re, kërkuesi sqaron se ka marrë dijeni më datë 21.03.2023 (ditën e dhënies së vendimit nga Gjykata e Lartë) dhe, për këtë arsye, i drejtohet Kolegjit me kërkesë për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, konkretisht vendimit nr. 9 (JR), datë 26.06.2020 të Kolegjit, bazuar në nenet 494-501 të Kodit të Procedurës Civile.

3.2. Referuar parashikimit të këtyre dispozitave, plotësohen në mënyrë kumulative të gjitha kushtet për rishikimin e vendimit, duke analizuar si në vijim.

(i) Vendimi gjyqësor i Gjykatës së Lartë përbën rrethanë të re në kuptimin e nenit 494, germa “a” e Kodit të Procedurës Civile, pasi përfundimisht vendosi mbi fajësinë e z. L. D. për falsifikimin e dokumenteve;

(ii) Kërkesa për rishikimin e vendimit të formës së prerë paraqitet brenda afatit 30-ditor nga marrja dijeni (20.04.2023). Kërkuesi pretendon se ky afat është respektuar, për sa kohë data e dhënies së vendimit është 21.03.2023.

(iii) Prova e re përmban të gjitha elementet e domosdoshme për vlefshmërinë e saj dhe i bashkëlidhet kërkesës në kopje autentike të lëshuar nga Gjykata e Lartë.

(iv) Rrethana ka rëndësi për kërkuesin pasi dëshmon se është gjykuar në këndvështrim me parimin e një procesi të rregullt ligjor, e konkretisht nga një gjykatë e pacaktuar me ligj.

(v) Fakti i falsifikimit të dokumenteve nga z. D. nuk dihej dhe nuk kishte mundësi të dihej nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit të ankimit në Kolegj, për sa kohë përbën një fakt penal, i cili duhej vërtetuar në proces gjyqësor dhe me vendim të formës së prerë.

3.3. Kërkuesi po ashtu argumenton se mundësia rishikuese është njohur edhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për të njëjtin shkak, me vendimin nr. 37474/20 *Besnik Cani kundër Shqipërisë*. GjEDNj-ja ka vendosur në mënyrë unanime se ka pasur shkelje të nenit 6/1 të KEDNj-së në lidhje me të drejtën e kërkuesit për një “gjykatë të krijuar me ligj”. Në kushtet kur vendimi i Kolegjit ka cenuar të drejta të qenësishme kushtetuese, siç është e drejta për të siguruar mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që shtetasi e ka zgjedhur vetë, dhe e drejta për të zgjedhur lirisht profesionin, vendin e punës, si dhe kualifikimin e tij profesional, kjo kërkesë shoqërohet edhe me atë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 9 (JR), datë 26.06.2020. Kjo masë pezulluese, sipas kërkuesit, do të pengonte shtimin dhe rëndimin e pasojave që një vendim i dhënë nga një gjykatë e pacaktuar me ligj do të prodhonte.

3.4. Në përfundim, z. Alfred Gjoni kërkon: “Rishikimin e vendimit nr. 9 (JR), datë 26.06.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 9 (JR), datë 26.06.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”. Bashkëngjitur kërkesës për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, kërkuesi ka paraqitur disa akte, e konkretisht: prokurë e posaçme nr. {***} rep., dhe nr. kol. {***}, datë 17.04.2023, nëpërmjet së cilës ai ka autorizuar avokatin Ardian Visha për përfaqësimin e tij në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit; një shkresë të Gjykatës së Lartë [me nr. {***} prot., datë 20.04.2023]; vendimin nr. 9 (JR), datë 26.06.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

3.5. Në datat 02.05.2025 dhe 05.05.2025, kërkuesi ka përcjellë në Kolegj parashtrime të titulluara “Paraqitje pretendimesh dhe provash shtesë” nëpërmjet të cilave shprehet për një rrethanë të re, e konkretisht, vendimin penal të marrë nga Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në datën 24.01.2024, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar më 18.11.2024, lidhur me gjyqtarin A. H.. Sipas kërkuesit, këto vendime përbëjnë bazë ligjore sipas germës “c” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, për të legjitimuar rishikimin e vendimit të formës së prerë.

II. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Procesi gjyqësor në Kolegj

Juridiksioni i Kolegjit

4. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu, sipas pikës 3 të këtij neni, Kolegji ka juridiksion të shqyrtojë: a) shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.
5. Në vijim të sa përmbledhet më sipër, rezulton se i gjithë kuadri kushtetues dhe ligjor që rregullon procesin e rivlerësimit nuk ka asnjë parashikim të shprehur literal, *së pari*, për të drejtën procedurale të paraqitjes së kërkesës për rishikim të subjekteve të rivlerësimit brenda kuadrit të zhvillimit të këtij procesi, dhe *së dyti*, as për ndonjë kompetencë të Kolegjit që ushtrohet tej funksionit kontrollues të vendimeve të Komisionit në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit, mbi bazën e ankimeve të paraqitura nga subjektet dhe Komisioneri Publik.
6. Duke konfirmuar të njëjtën linjë arsyetimi sikurse në vendimin e tij të mëparshëm, me nr. 12, datë 19.04.2024, që u përket kërkesave për rishikim të kërkuesit A. Y., trupi gjykues i Kolegjit rithekson edhe në këtë rast, në mënyrë të përmbledhur, atë qëndrim për sa i përket interpretimit të dispozitave të Kushtetutës, të nenit F të Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016 kundrejt juridiksionit rishikues të vendimeve të formës së prerë në procesin e rivlerësimit kalimtar. Koncretisht, nga leximi harmonik i këtyre rregullimeve për sa i përket juridiksionit rivlerësues e rishikues të Kolegjit, trupi gjykues vëren se në to parashikohet në mënyrë të shprehur vetëm juridiksioni rivlerësues i Kolegjit, në funksion të kontrollit ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në ankimet e subjekteve të rivlerësimit apo ato të ushtruara nga komisionerët publikë. Trupi gjykues ka theksuar se, nga analiza e kuadrit rregullator të posaçëm, nuk rezulton të ketë asnjë parashikim të shprehur për ushtrimin e juridiksionit rishikues të Kolegjit, sipas kërkesës së parashtruar prej kërkuesit në çështjen objekt shqyrtimi. Mungesa e një parashikimi të tillë në ligjin e posaçëm, e shoqëruar edhe me mungesën e

rregullave për trajtimin e kërkesave të tilla, diktoi nevojën e analizimit nga trupi gjykues i çështjes së cituar më sipër, të dispozitave që thirren për zbatim nga ligji nr. 84/2016.

7. Trupi gjykues i Kolegjit në vendimin e referuar më sipër, ka arritur në konkluzionin se Kolegji i Posaçëm i Apelit nuk ka juridiksion rishikues si një prej tagrave të tij dhe nuk është ngritur për t'i dhënë jetë këtij instituti sipas rregullimeve të përgjithshme të tij, parashikuar në nenin 494 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve në të cilat gjen zbatim germa “ë” e nenit 494, për shkak të një vendimi të shprehur të GjEDNj-së në trajtimin e një ankimi. Sikurse analizuar në detaj në vendimin e sipërcituar të Kolegjit, është analizuar përse procesi i rivlerësimit, duke qenë *sui generis*, me mandat në kohë të kufizuar dhe rregulluar me një kuadër kushtetues e ligjor të posaçëm, e bën të pabazuar kërkesën për rishikim të paraqitur nga kërkuksi.
8. Leximi harmonik i dispozitës së nenit F, pika 8² e Aneksit të Kushtetutës dhe germës “ë” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile³ – një vendim i GjEDNj-së që konstaton një shkelje të kryer në çështjen e një ankuesi konkret – konsiderohet si i vetmi mjet procedural që kanë në dispozicion subjektet e rivlerësimit, në rast se të drejtat e tyre shkelen nga Kolegji në gjykimin e çështjeve të tyre dhe si e vetmja mundësi për të korrigjuar çdo gabim gjyqësor që mund të jetë konstatuar. Ky parashikim drejton subjektet drejt GjEDNj-së, duke konfirmuar natyrën e jashtëzakonshme të procesit, përjashtimin nga rregullat e zakonshme procedurale dhe orientimin për adresimin në këtë gjykatë të çdo problematike që është konstatuar përgjatë procesit e që ka çuar edhe në ndonjë gabim gjyqësor. Si rrjedhojë, subjektet e rivlerësimit kanë të drejtë të ankimojnë vendimet e Kolegjit në GjEDNj për çdo rast që ata konsiderojnë se vendimmarrja ndaj çështjes së tyre të rivlerësimit është në shkelje të parashikimeve të Konventës dhe Protokolleve të saj, të mbrojtura në Kushtetutë. Sipas këtij parashikimi, për trajtimin e të drejtave themelore të njeriut, GjEDNj-ja në sistemin tonë juridik ka një kompetencë ekskluzive.
9. Konkretisht, rrethanat që ligji parashikon se përbëjnë bazë për rishikimin e vendimeve, vlerësohet se nuk gjejnë zbatim në kontekstin e procesit të rivlerësimit të kërkuksit. Në kushtet që procesi i rivlerësimit është i jashtëzakonshëm dhe zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës nga organe me mandat të kufizuar kohor, për shkak të objektivit dhe natyrës së tij *sui generis*, që rezulton edhe nga mënyra sesi është rregulluar në ligj, Kolegji do të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit përkatës, sipas germës “ë” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, lexuar në harmoni me pikën 8 të Nenit F të Aneksit të Kushtetutës.
10. Nga këto dy dispozita, të lexuara në harmoni me njëra-tjetrën, rezulton se vendimet e Kolegjit mund të ankimohen vetëm në GjEDNj dhe që pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi të formës së prerë kur GjEDNj-ja ka gjetur shkelje të Konventës dhe protokolleve

² Subjektet që rivlerësohen mund të ushtrojnë ankim në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

³ “[...] Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë kur: [ë] Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të Konventës Evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

të saj. Në këtë kontekst, në kushtet që për kërkuesin nuk ka një vendim, nëpërmjet të cilit GjEDNJ-ja konkludon një shkelje të kryer në procesin e rivlerësimit të tij, duke rikonfirmuar pa përsëritur arsyetimin e kryer nga Kolegji në jurisprudencën e tij [referuar edhe më sipër dhe në poshtëshënim], kërkesa për rishikim nuk bën pjesë në juridiksionin e rivlerësimit kalimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, sipas përcaktimit të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe as në juridiksionin rishikues të Kolegjit, sipas pikës 8 të nenit F të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile.

11. Së fundmi, dhe si *obiter dictum*, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje edhe se shkaqet e rishikimit të paraqitura prej kërkuesit Alfred Gjoni janë të njëjta me shkaqet e marra në shqyrtim më parë nga Kolegji dhe elaboruar në jurisprudencën e tij. Në kushtet që kërkesa përmban arsyetimin e bazuar mbi të njëjtat shkaqe si në vendimin e Kolegjit, nr. 34/2023 dhe nr. 4/2024, për dy subjektet respektive⁴, R. G. dhe A. G., kërkesa do të vlerësohej njësoj e pabazuar nëse do t'i nënshtrohej shqyrtimit gjyqësor mbi të njëjtat argumente pasi mungon lidhja shkakësore mes vendimmarrjes së gjyqtarit L. D. në çështjen e rivlerësimit të kërkuesit dhe veprës penale për të cilën ai është deklaruar fajtor. Në asnjë prej rrethanave të parashikuara, ligji nuk u referohet ndodhjeve, fakteve apo rrethanave të cilat nuk rrjedhin apo paraprijnë apo janë shkak për marrjen e vendimit për të cilin kërkohet rishikimi. Nga ky lexim rezulton se në mënyrë që vepra penale, për të cilën anëtar i trupit gjykues është gjetur fajtor, të ketë ndikuar në dhënien e vendimit, pala kërkuese duhet të provojë lidhjen shkakësore mes veprës penale dhe vendimit të atakuar nëpërmjet rishikimit, ose që në momentin kur gjyqtari/gjyqtarja ka marrë vendimin, vullneti i tij/saj është vesuar për shkak të një vepre penale, e cila ka ndikuar në vendimmarrjen objekt rishikimi. Të tilla raste do të ishin sjelljet e një gjyqtari/gjyqtareje në shkelje të parimeve të paanësisë e objektivitetit, provuar nga një vendim penal i formës së prerë. Një analizë e kryer duke aplikuar këto parime është në linjë edhe me jurisprudencën e GjEDNJ-së, shtjelluar në drejtim të sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë që diktojnë parimet e nenit 6/1 të Konventës, si në çështjen *Brumarescu*, ku është elaboruar që cenimi i një vendimi përfundimtar mund të legjitimohej vetëm për të korrigjuar një “dështim të drejtësisë”⁵.
12. Fakti që në rastin konkret vepra e dënueshme penalisht është kryer nga z. L. D. para marrjes së detyrës si gjyqtar i Kolegjit, dhe disa vite para dhënies së vendimit të Kolegjit që kërkohet të rishikohet, e shkellet këtë lidhje logjike dhe ligjore që kanë dy rrethanat e mësipërme, duke mos plotësuar njëkohësisht *qenien gjyqtar* dhe *kryerjen e veprës të dënueshme penalisht*. Rëndësi në vlerësimin e kushteve për rishikimin e një vendimi ka dhe fakti se, sipas dispozitës, vepra e dënueshme penalisht jo vetëm duhet të jetë kryer gjatë periudhës që gjyqtari ka qenë në detyrë, por duhet të provohet dhe që ajo ka lidhje dhe ka ndikuar drejtpërdrejt në vendimin që kërkohet të rishikohet. Vepra penale për të cilën është dënuar ish-gjyqtari, “Falsifikim i dokumenteve”, për nga lloji i saj nuk rezulton të ketë lidhje dhe të duket se mund të ketë ndikuar

⁴https://kpa.al/wp-content/uploads/2024/11/Vendimi_Rovena_Gashi_perfshire_mendimin_paralel_anonimizuar.docx-1.pdf.

⁵https://kpa.al/wp-content/uploads/2024/11/Vendimi_Ana_Golloshi_perfshire_mendimin_paralel_anonimizuar-1-rishikim.pdf

⁵ *Shih Brumarescu kundër Rumanisë, Pravednaya kundër Rusisë* parag. 25, *Bratyakin kundër Rusisë*, ndër të tjerë.

në vendimin për kërkuesin në kuadër të procesit të rivlerësimit. Për sa kohë që kërkuesi nuk sjell asnjë argument dhe provë konkrete se kryerja e veprës penale ka qenë e lidhur drejtpërdrejt me prekjën e interesave të tij, nuk shpjegohet se si kjo vepër penale mund të ketë ndikuar dhe të ketë qenë shkak determinant në vendimin e dhënë ndaj tij.

13. Ky këndvështrim vjen në linjë me arsyetimin e Gjykatës Kushtetuese në jurisprudencën⁶ e saj, sipas të cilit kërkesa për rishikim, duke qenë një mjet i jashtëzakonshëm, nëpërmjet të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi gjyqësor të formës së prerë, mund të bazohet vetëm në një numër të kufizuar shkaqesh, të parashikuara shprehimisht nga dispozitat procedurale përkatëse. Për këto arsye, edhe parë në këtë këndvështrim, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, nëse çështja do të ishte marrë në shqyrtim, germa “c” e nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile nuk mund të argumentohet se gjen zbatim.
14. Sa më sipër, për sa kuadri kushtetues dhe ligjor i rivlerësimit, si dhe institucionet që e kryejnë atë japin garanci maksimale për të shmangur shkaqet e parashikuara në 6 gerrat e para të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, vlerësohet se jo pa qëllim kushtetutëbërësi ka parashikuar ankimin ndaj vendimeve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në GjEDNj. Si rrjedhojë e sa më sipër, nga leximi harmonik i nenit 179/b të Kushtetutës, nenit F të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile, Kolegji do të kishte juridiksion rishikues vetëm mbi bazë të një vendimi të GjEDNj-së që potencialisht do të konstatonte se ekzistojnë shkaqet që përlligjin shqyrtimin e një vendimi të formës së prerë të tij, nëpërmjet rihapjes së procesit, për të rivendosur të drejtën e cenuar.
15. Në analizë të sa më sipër, i jepet përgjigje përfundimtare kërkesës së paraqitur prej kërkuesit Alfred Gjoni, për të cilin GjEDNj-ja nuk ka marrë ende një vendim. Kjo kërkesë nuk mund të shqyrtohet nga Kolegji, për shkak të mospasjes prej tij të juridiksionit rishikues, sipas referimeve që kërkuesi bën në nenin 494, germa “c” e Kodit të Procedurës Civile. Në përfundim, sipas analizës së dispozitave kushtetuese dhe ligjore, si dhe referuar jurisprudencës⁷ së Kolegjit, trupi gjykues vlerësoi se Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së në përgjigje të ankimit të vetë kërkuesit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së.
16. Për sa më lart, kërkesa e paraqitur prej kërkuesit Alfred Gjoni nuk bën pjesë në juridiksionin e rivlerësimit kalimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, sipas përcaktimit të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe as në juridiksion rishikues të Kolegjit, sipas përcaktimit të nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës e nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile, për pasojë kjo kërkesë konsiderohet nga trupi gjykues si e papranueshme.

⁶ Shih vendimet nr. 36, datë 26.07.2011, si dhe nr. 76, datë 22.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese.

⁷ Vendimi nr.12, datë 19.04.2024, i Kolegjit që u përket kërkesave për rishikim të kërkuesit A. Y.; vendimi nr. 9, datë 28.02.2025, i Kolegjit që i përket kërkesës për rishikim të kërkuesit A. B.; vendimi nr. 10, datë 28.02.2025, i Kolegjit që i përket kërkesës për rishikim të kërkuesit B. M..

17. Në përfundim, sipas analizës harmonike dhe të gjithanshme të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, si dhe orientimeve të instrumenteve ndërkombëtarë, që kanë normuar procesin e rivlerësimit kalimtar, trupi gjykues vlerësoi se Kolegji i Posaçëm i Apelit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së në përgjigje të ankimit të vetë kërkuesit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së. Situatat e tjera të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm, për t’u zbatuar si rrethana për rishikimin e vendimeve civile/administrative të marra në përfundim të një procesi kontradiktor, u vlerësuan se nuk gjejnë zbatim brenda kontekstit të procesit të rivlerësimit, i cili është një proces i jashtëzakonshëm, i realizuar prej organeve me mandat të kufizuar dhe që zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.
18. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se, ndonëse shkaqet e rishikimit të paraqitura prej kërkuesit nuk i nënshtrohen juridiksionit rishikues të Kolegjit sipas arsytimit të mësipërm, sërish ato konstatohen se janë të njëjta me shkaqet e marra në shqyrtim deri tani në jurisprudencën e Kolegjit në raste⁸ të ngjashme, dhe do të vlerësoheshin njësoj si të pabazuara edhe nëse do t’i nënshtroheshin shqyrtimit gjyqësor. Në kushtet që vepra penale për të cilën është deklaruar fajtor ish-gjyqtari L. D. referohet të jetë kryer vite përpara vendimit dhe nuk ka asnjë lidhje shkakësore me vendimin për të cilin kërkohet rishikimi, neni 494, germa “c” e Kodit të Procedurës Penale nuk mund të argumentohet se gjen zbatim, elaboruar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit në çështje të tjera⁹. Po ashtu, pretendimet e parashtrimet shtesë të depozituara lidhur me gjyqtarin A. H. u vlerësuan se nuk përbëjnë kërkesë të re e autonome. Në këtë konsideratë, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë edhe që procesi gjyqësor që përfshin gjyqtarin A. H. nuk ka përfunduar me vendim të formës së prerë.
19. Për sa më lart, trupi gjykues arriti në përfundimin se kërkesa e paraqitur prej kërkuesit Alfred Gjoni nuk bën pjesë në juridiksionin e rivlerësimit kalimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, sipas përcaktimit të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe as në juridiksionin rishikues të Kolegjit, sipas përcaktimit të nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës e nenit 494, shkronja “ë” e Kodit të Procedurës Civile, për pasojë, ajo konsiderohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 498, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile,

⁸ Vendimet e Kolegjit nr. 34, datë 06.12.2023, dhe nr. 4, datë 15.02.2024.

⁹Shih për referencë vendimin që i përket kërkesës së znj. R. G.:

[https://kpa.al/wp-](https://kpa.al/wp-content/uploads/2024/11/Vendimi_Rovena_Gashi_perfshire_mendimin_paralel_anonimizuar.docx-1.pdf)

[content/uploads/2024/11/Vendimi_Rovena_Gashi_perfshire_mendimin_paralel_anonimizuar.docx-1.pdf](https://kpa.al/wp-content/uploads/2024/11/Vendimi_Rovena_Gashi_perfshire_mendimin_paralel_anonimizuar.docx-1.pdf).

Edhe vendimin që i përket kërkesës së znj. A. G.:

https://kpa.al/wp-content/uploads/2024/11/Vendimi_Ana_Gollosi_perfshire_mendimin_paralel_anonimizuar-1-rishikim.pdf.

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës së kërkuarit Alfred Gjoni për rishikimin e vendimit nr. 9 (JR), datë 26.06.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 08.05.2025.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Albana Shtylla, jam dakord me zgjidhjen e çështjes për vendimin nr. 18, datë 08.05.2025, për çështjen 57-17/2019 regjistër (JR) datë 24.04.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me të cilin është vendosur mospranimi i kërkesës së kërkuarit Alfred Gjoni, për rishikimin e vendimit nr. 9 (JR), datë 26.06.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, por kam mendim paralel, lidhur me arsyetimin e shumicës së trupit gjykues, për sa parashtruar në vijim.
2. Trupi gjykues në përfundim ka konkluduar se *Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit të vetë kërkuarit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së. Situatat e tjera të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm, për t’u zbatuar si rrethana për rishikimin e vendimeve civile/administrative të marra në përfundim të një procesi kontradiktor, u vlerësuan se nuk gjejnë zbatim brenda kontekstit të procesit të rivlerësimit, i cili është një proces i jashtëzakonshëm i realizuar prej organeve me mandat të kufizuar dhe që zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.*
3. Në ndryshim nga shumica, në analizë harmonike të dispozitave kushtetuese, ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji “nr. 84/2016”) dhe legjislacionit në fuqi, kam vlerësuar se Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka juridiksion rishikues për të shqyrtuar kërkesat për rishikim bazuar në të gjitha rrethanat e parashikuara të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile. Ky qëndrim bazohet në argumentet e referuara prej meje në mendimin paralel për kërkesat për rishikim të paraqitura nga kërkuari A. Y.¹⁰.
4. Sa i përket shkaqeve të rishikimit të paraqitura në kërkesën e z. Alfred Gjoni, kam ndarë të njëjtin qëndrim si edhe pjesa tjetër e trupit gjykues, të pasqyruar në paragrafin 11 të vendimit, duke i konsideruar ato të pabazuara mbi të njëjtat argumente, duke vendosur mospranimin e tyre.

GJYQTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

¹⁰ Shiko mendimin paralel në vendimin nr.12, datë 19.04.2024 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit https://kpa.al/wp-content/uploads/2024/11/Vendim-JR-Artor-Ylli_perfshire-mendimet-paralele_anonimizuar_word-1.pdf

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, jam dakord me vendimin nr. 18 (JR), datë 08.05.2025, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) për: *Mospranimin e kërkesës së kërkuarit Alfred Gjoni për rishikimin e vendimit nr. 9 (JR), datë 26.06.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit*, por me arsyetim ndryshe lidhur me arsyet se përse kërkesa për rishikim, e kërkuarit, nuk duhet pranuar nga Kolegji, sipas parashikimeve të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Arsyetimi i përdorur në vendim nga trupi gjykues, se: [...] *Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit të vetë kërkuarit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së, në vlerësimin tim si gjyqtare me mendim paralel, nuk qëndron pasi vjen si pasojë e një diferencimi dhe interpretimi alogjik të situatave të parashikuara në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile, duke i atribuar Kolegjit mundësinë e rishikimit vetëm për rastin e parashikuar nga shkronja “ë” e kësaj dispozite: kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të Konventës Evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Kolegji nuk mund të ushtrojë këtë juridiksion në një kohë që Kushtetuta dhe ligji nuk e parashikon rishikimin për vendimet përfundimtare të Kolegjit.*
3. Në mungesë të një referimi ligjor të juridiksionit rishikues të Kolegjit, rishikimi në këtë rast është jo i zbatueshëm dhe nuk mund të aplikohet nga ana e Kolegjit. Në vlerësim tim, jo pa qëllim kushtetutëbërësi nuk e ka çmuar të zbatueshëm institutin e rishikimit për vendimet e Kolegjit, duke mos e trajtuar në asnjë dispozitë kushtetuese dhe ligjore, pasi ka vlerësuar se procesi i rivlerësimit është kalimtar dhe jo i zakonshëm, si dhe me mandat të kufizuar. Për këto arsye, si gjyqtare me mendim paralel, vlerësoj se mbetet detyrë pikërisht e ligjvënësit për të rregulluar këtë situatë të krijuar, duke rishikuar kuadrin ligjor aktual me qëllim përfshirjen e parashikimeve ligjore, duke përcaktuar gjykatën kompetente dhe modalitetet respektive për kryerjen e rishikimit të vendimeve të Kolegjit, të kërkuara nga subjektet e rivlerësimit në raport me të gjitha rrethanat e nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile.
4. Në kushtet kur Kushtetuta dhe ligji nuk i ka atribuar Kolegjit juridiksion rishikues, ndaj mendimin se ky institucion nuk mund të ushtrojë këtë tagër ndaj vendimeve të tij.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, në cilësinë e anëtares, jam dakord me zgjidhjen e çështjes në vendimin nr. 18, datë 8.5.2025, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) që i përket shqyrtimit të kërkesave të kërkuarit Alfred Gjoni për rishikimin e vendimit gjyqësor nr. 9 (JR), datë 26.6.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, por kam ndarë mendim ndryshe sa i përket qëndrimit të mbajtur lidhur me arsyetimin për mungesën e juridiksionit rishikues¹¹ të Kolegjit për shqyrtimin e kërkesave që nuk kanë një vendim të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GjEDNJ”), sipas shkronjës “ë” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile.
2. Në vlerësimin tim, Kolegji ka juridiksion rishikues për shqyrtimin e kërkesave për rishikim vendimi që janë paraqitur bazuar në nenin 494¹² të Kodit të Procedurës Civile dhe argumentet e mia shkojnë në të njëjtën linjë arsyetimi të përdorur nga gjyqtarja Albana Shtylla në mendimin e saj paralel, shprehur në vendimin e kërkuarit A. Y. (referuar në poshtëshënimin nr. 1). Përveç sa janë renditur në këtë mendim paralel, po parashtroj edhe disa argumente shtesë me të cilat vlerësoj se shpreh qartë kundërshtimin tim për mungesën e juridiksionit rishikues mbajtur nga shumica e trupit gjykues edhe në rastin e kërkuarit Alfred Gjoni.
3. Kolegji, me trupat gjykues respektivë, në vendimin e kërkuarit A. Y. dhe në këtë vendim të kërkuarit Alfred Gjoni, ndër të tjera, ka arritur në përfundimin se nuk ka parashikim eksplicit për ushtrimin prej tij të juridiksionit rishikues pasi kuadri normativ kushtetues dhe ligji i posaçëm i rivlerësimit nr. 84/2016 nuk e parashikojnë rishikimin e për pasojë kërkesa është e papranueshme. Në vlerësimin tim, ky përfundim dhe interpretim është juridikisht i kontestueshëm sepse mungesa e parashikimit eksplicit në ligj nuk do të thotë njëkohësisht mungesë kompetence nga ana Kolegjit, pasi gjykatat kanë jo vetëm kompetencat e shprehura, por edhe ato të domosdoshme për të garantuar drejtësinë, ku përfshihen kompetencat e nënkuptuara (*juridiksioni implicit*). Në këtë kuptim, Kolegji nuk mund të kufizojë kompetencën vetëm për arsye se mungon dispozita e shprehur.

¹¹Ky qëndrim është mbajtur nga shumica e trupës gjykuese në vendimin nr. 12, datë 19.4.2024, që ka shqyrtuar kërkesën e kërkuarit A. Y., regjistruar me nr. 2-4/2019 regjistër (JR), datë 10.1.2022, me objekt “Rishikimi i vendimit të formës së prerë nr. 31 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”, në të cilin nuk kam qenë anëtare e trupit gjykues. Në këtë vendim dy anëtare të trupit gjykues kanë shprehur mendim paralel lidhur me arsyetimin e shumicës (N. Mulaj dhe A. Shtylla).

¹²Neni 494 i KPrC: “Kërkesa për rishikim është akti me të cilin kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, kur: a) zbulohen rrethana të reja apo prova të reja me shpresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të dihen nga pala gjatë shqyrtimit të saj; b) vërtetohet se thëniet e dëshmitarëve apo mendimet e ekspertëve, mbi të cilat është bazuar vendimi, kanë qenë të rreme; c) palët ose përfaqësuesit e tyre apo ndonjë anëtar i trupit gjykues, që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes, kanë kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në dhënien e vendimit; ç) vërtetohet se vendimi i dhënë është bazuar në dokumente të falsifikuara; d) vendimi është bazuar në një vendim të gjykatës ose të një institucioni tjetër që më pas është prishur; e) vendimi është në kundërshtim të hapur me një vendim tjetër të formës së prerë të dhënë midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. ë) kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.”

4. Në vendimin e Kolegjit për A. Y., argumentohet se ligji nr. 84/2016 nuk parashikon rishikim të një vendimi përfundimtar. Por, në argumentet e mia, në ndryshim nga shumica, vlerësoj se Kolegji, si gjykatë e fundit e procesit të rivlerësimit duhet të ketë mekanizëm korrigjues, dhe instituti i rishikimit, edhe pse një mjet i jashtëzakonshëm, përbën një standard që në fund të fundit do të garantojë procesin e rregullt dhe dhënien e drejtësisë. Nëse Kolegji nuk bën rishikim të vendimeve përfundimtare kur konstatohet se: (i) ka shkelje serioze procedurale; (ii) cenim të parimit të gjykatës së krijuar me ligj; (iii) gabime të rënda gjyqësore, kjo do të çojë në shkelje të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim KEDNj-së), pasi do të kufizojë përdorimin e një mjeteve efektiv (rishikimit) edhe kur ligji i posaçëm nuk e ndalon shprehimisht rishikimin, madje ligji nr. 84/2016, në nenin 4, pika 6, ka krijuar hapësirën dhe bazën ligjore që ndërlidh në mënyrë harmonike e integrale zbatimin e tij me kuadrin ligjor në fuqi, konkretisht Kodin e Procedurave Administrative dhe ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar. Gjithashtu, Kolegji, kur është rasti, zbaton edhe dispozitat e Kodit të Procedurës Civile për gjykatën që shqyrton kërkesat për rishikim, e konkretisht nenin 497, pika 1 e këtij Kodi.
5. Në vendimin nr. 12/2024 (rishikimi i vendimit nr. 31/2019 (JR), të kërkuarit A. Y.), në arsyetimin e bërë, është arritur në përfundimin se Kolegji ka juridiksion rishikues vetëm për shkronjën “ë” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, e cila parashikon rishikimin kur GjEDNj-ja konstaton shkelje të Konventës në procesin e rivlerësimit të subjektit dhe rihapja e çështjes është e nevojshme për të rivendosur të drejtat. Në ndryshim nga shumica, unë vlerësoj se parashikimi i shkronjës “ë” është vetëm një nga shkaqet e rishikimit dhe jo i vetmi. Kodi i Procedurës Civile ka disa baza rishikimi që përcaktohen qartë në shkronjat “a” deri në “e” të nenit 494 dhe shkronja “ë” nuk është baza e vetme e rishikimit në sistemin procedural. Një interpretim i tillë, në vlerësimin tim, është i diskutueshëm dhe potencialisht i cunguar sepse neni 494 nuk është normë kufizuese, por një listë shkaqesh rishikimi. Nëse zbatohet Kodi i Procedurës Civile, zbatohet i gjithë instituti, jo vetëm një shkronjë e tij, në të kundërt natyrshëm dhe logjikshëm mund të lindin pyetjet: pse juridiksioni ekziston vetëm për një shkak dhe jo për të tjerët? Ku përcaktohet kompetenca “përzgjedhëse” e Kolegjit për të zbatuar vetëm një nga disa prej shkaqeve të rishikimit? Nëse Kolegji pranon rishikimin sipas shkronjës “ë”, ai *de facto* ka pranuar ekzistencën e juridiksionit rishikues.
6. Në vijim të argumenteve të ndryshme me shumicën e trupit gjykues, do të shtoja se një interpretim që pranon rishikimin vetëm pas vendimit të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit të kërkuarit (subjekt rivlerësimi), e bën juridiksionin rishikues të varur vetëm nga gjykata e Strasburgut, duke hequr mundësinë e çdo mekanizmi korrigjues të brendshëm dhe duke krijuar një vakum juridik për shkelje serioze që nuk kanë arritur ende në GjEDNj.
7. Pranimi i juridiksionit rishikues vetëm në mënyrë minimaliste dhe vetëm për vendimet e GjEDNj-së, në vlerësimin që i bëj çështjes, duket se krijon një kontradiktë logjike, sepse e bën rishikimin një “mjet të jashtëm” dhe jo “mjet të brendshëm”, duke lënë pa zgjidhje gabimet serioze të brendshme që përbëjnë shkaqet e rishikimit sipas shkronjave të tjera të nenit 494 të Kodit. Pra, nëse rishikimi do të ekzistojë vetëm pasi GjEDNj-ja të shprehet me një vendim të

posaçëm për kërkuesin (subjekt rivlerësimi), kjo do të passillte që mjete i brendshëm të mos jetë efektiv¹³ dhe kjo mund të çojë në shkelje të nenit 13¹⁴ të KEDNJ-së.

8. Nëse do t'i referohemi jurisprudencës¹⁵ së GjEDNJ-së në lidhje me sa argumentuar më lart, vërejmë se, për korrigjimin e shkeljeve, kjo gjykatë është shprehur se shteti duhet të ketë një mekanizëm efektiv të brendshëm dhe nuk mund të lejohet që korrigjimi të ndodhë vetëm pasi ndërhyrja Strasburgu, madje mekanizmi i brendshëm duhet të jetë real dhe funksional, në të kundërt boshllëku juridik mund të bëhet serioz. Edhe Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, është shprehur për rëndësinë e kontrollit efektiv nga një organ që ofron garantimin e pavarësisë dhe paanësisë gjatë procesit të shqyrtimit të konfliktit¹⁶.
9. Në leximin dhe interpretimin që unë i bëj shkronjës “ë” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, nuk më rezulton që ky parashikim të jetë “i dedikuar” për kërkuesin e posaçëm, në rastin konkret një subjekt rivlerësimi drejtuar GjEDNJ-së. Ky parashikim ligjor, i shtuar në Kod në vitin 2008, me ligjin nr.10052, është një pasurim i legjislacionit shqiptar edhe me jurisprudencën e GjEDNJ-së në kuadër të detyrimeve që rrjedhin nga Kushtetuta¹⁷, për zbatimin e Konventës si dhe të vendimeve të GjEDNJ-së.
10. Në interpretimin teleologjik që shumica e trupit gjykues të Kolegjit u ka bërë dispozitave të Kushtetutës, përfshirë edhe atë kufizuese në nenin A të Aneksit të saj, si dhe kuadrin normativ të aplikueshëm të procesit të rivlerësimit kalimtar, është arsyetuar dhe janë përzgjedhur argumente juridike për të arritur në përfundimin e mospranimit të juridiksionit rishikues edhe pse vetë Kolegji pranon nevojën për mbrojtjen e procesit të rregullt ligjor dhe korrigjimin e gabimeve gjyqësore. Në leximin që i bëj vendimit, më krijohet perceptimi se argumentet e përdorura për interpretimin e Kushtetutës nga shumica, shkojnë në favor të pranimit të këtij juridiksioni, duke mbajtur në konsideratë që interpretimi teleologjik duhet të favorizojë drejtësinë dhe jo formalizmin procedural.
11. Në vijim të argumenteve të mia të kundërta lidhur me konkluzionin për mungesën e juridiksionit rishikues të Kolegjit për shkronjat “a-e” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, pyetjet që më kanë lindur natyrshëm në këtë rast janë:
 - Cila gjykatë e ka juridiksionin rishikues kur Kolegji e ka deklaruar mungesën e tij?

¹³Çështja “Scordino v. Italy (No. 1) (GC, 2006) (Application no. [36813/97](https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-72925)) - <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-72925>”.

¹⁴Neni 13 i KEDNJ-së: “Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

¹⁵Çështja “KUDŁA v. POLAND (Application no. [30210/96](https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-58920)) - <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-58920>”.

¹⁶Vendimi 10/2007, në lidhje me interpretimin e nenit 36 “Juridiksioni” të Kodit të Procedurës Civile.

¹⁷Neni 5 i Kushtetutës: “Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të”.

Neni 122 i Kushtetutës: “1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji [...]”.

- Kujt duhet t'i drejtohen ish-subjektet e rivlerësimit kur pretendojnë se ka lindur një shkak për rishikimin e vendimit përfundimtar të dhënë nga Kolegji në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar?

12. Me një përgjigje të shpejtë mund të drejtohem i Gjykata Kushtetuese (si opsioni kryesor në planin e brendshëm), meqenëse në praktikën kushtetuese shqiptare kur pretendohet për shkelje të nenit 42 të Kushtetutës (proces i rregullt), për një gjykatë jo të krijuar me ligj dhe për cenim të të drejtave themelore nga një vendim gjyqësor përfundimtar, juridiksioni kalon te Gjykata Kushtetuese përmes ankimit kushtetues individual. Por, a mundet Gjykata Kushtetuese të shqyrtojë ankimin kushtetues individual apo rishikimin e vendimeve përfundimtare të dhëna nga Kolegji në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, kur atributet kushtetuese dhe ligjore i janë dhënë me tagra të plotë vetëm Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe vendimet e këtij të fundit¹⁸ kontrollohen vetëm nga Gjykata e Strasburgut? Nga praktika e Gjykatës Kushtetuese, konstatojmë se me vendimin nr. 62, datë 29.4.2020, Kolegji paraparak ka vendosur moskalimin e çështjes së kërkuarit B. C.¹⁹ për shqyrtim në seancë plenare²⁰, pasi ka vlerësuar, ndër të tjera, se:

21. Gjykata Kushtetuese gjatë jurisprudencës së saj ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor, përfshirë edhe pretendimet për gjykatën e caktuar me ligj, garantohet gjatë një procesi ligjor ose gjyqësor, në funksion të rezultatit përfundimtar, që sjell pasoja konkrete dhe të drejtpërdrejta për kërkuar, si bartës të të drejtave kushtetuese procedurale dhe substanciale. Kolegji vlerëson se edhe në procesin e rivlerësimit kalimtar, të drejtat procedurale të subjekteve të rivlerësimit duhet të garantohen brenda procesit gjyqësor që zhvillohet nga KPA-ja, sipas kompetencave që Kushtetuta dhe ligji i ka ngarkuar.

22. Në vështrim të kësaj analize, Kolegji vlerëson se akti i kundërshtuar nga kërkuar është akt i pushtetit publik i natyrës individuale, me anë të të cilit Kuvendi ka shprehur vullnetin e tij për krijimin dhe formësimin e organeve kushtetuese të rivlerësimit kalimtar, i cili nuk është drejtpërdrejt i zbatueshëm për subjektet e rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, nuk sjell pasoja të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuarin.

23. Gjithashtu, Kolegji thekson se juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese në shqyrtimin e ankimit individual kushtetues të kërkuarit, që lidhet me kryerjen e rivlerësimit kalimtar të tij për shkak të detyrës së prokurorit, është i kufizuar nga juridiksioni që vetë Kushtetuta, në aneksin e saj, u ka dhënë organeve të rivlerësimit. Kështu, neni 179/b,

¹⁸ Neni F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës parashikon: “Subjektet që rivlerësohen mund të ushtrojnë ankim në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

¹⁹ Objekti i kërkesës: “Verifikimi i zgjedhjes dhe shfuqizimi pjesërisht i vendimit nr. 82/2017 “Për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të Kuvendit të Shqipërisë, vetëm për sa i përket zgjedhjes së z. L. D. si anëtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Pezullimi pjesërisht i vendimit nr. 82/2017 “Për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të Kuvendit të Shqipërisë, vetëm për sa i përket zgjedhjes së z. L. D. si anëtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

²⁰ Gjykata Kushtetuese ka shqyrtuar edhe kërkesa nga kërkuar të tjerë (subjekte rivlerësimi), me të njëjtin objekt si më lart dhe ka vendosur moskalimin për shqyrtim në seancë plenare.

pika 2 e Kushtetutës parashikon se procesi i rivlerësimit, që realizohet nga KPK-ja dhe KPA-ja, do të kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt ligjor, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të vlerësimit. Ndërsa në nenin A, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, parashikohet se me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, zbatimi i ankimit individual kushtetues kufizohet pjesërisht për subjektet e rivlerësimit, sipas nenit 17 të Kushtetutës.

24. Kolegji rithekson se të gjitha të drejtat procedurale kushtetuese, të parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës, përfshirë edhe standardin e “gjykatës së krijuar me ligj”, Kushtetuta ua ka garantuar subjekteve të rivlerësimit, përmes procesit gjyqësor në KPA dhe, më pas, përmes mundësisë së ushtrimit të së drejtës së ankimit pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Duke pasur parasysh kompetencat e KPA-së, si organi që kontrollon vendimmarrjen e KPK-së, Gjykata ka vlerësuar se ky proces kontrollohet edhe nga pikëpamja e pajtueshmërisë së tij me Kushtetutën (shih vendimin nr.2, datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese).

13. Pra, Gjykata Kushtetuese qartësisht ka deklaruar se juridiksioni i saj në shqyrtimin e ankimit individual kushtetues që lidhet me kryerjen e rivlerësimit kalimtar është i kufizuar nga juridiksioni që vetë Kushtetuta, në aneksin e saj, u ka dhënë organeve të rivlerësimit, e konkretisht Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Në këto kushte, Kolegji duke mos u shprehur se kush e ka kompetencën për juridiksionin rishikues, krijon premisa për shkelje të nenit 6, pika 1 e KEDNj-së dhe mohim të së drejtës të aksesit në gjykatë. Këtë qëndrim e gjejmë edhe në vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese, e cila, ndër të tjera, shprehet se mohimi i së drejtës së aksesit, domethënë i së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare nga ajo, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor²¹.
14. Kolegji, me interpretimin e bërë në vendimin nr. 12/2024 (rishikimi për kërkesën e A. Y.), ka ndryshuar qëndrimin e mbajtur prej tij në 2 (dy) vendime të mëparshme në shqyrtimin e kërkesave për rishikim të kërkueseve R. G.²² dhe A. G.²³. Në këto vendime, Kolegji, pasi ka deklaruar pasjen e juridiksionit rishikues²⁴, ka shqyrtuar kërkesat²⁵ dhe ka konkluduar që pretendimet e tyre nuk përbëjnë shkak për rishikim, sipas parashikimeve të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, duke vendosur për mospranimin e tyre pasi ka shqyrtuar arsyet e paraqitura në kërkesat respektive. Ndryshimi i qëndrimit të Kolegjit, pasi kishte dhënë vendime ku kishte pranuar ekzistencën e juridiksionit rishikues, por nuk kishte pranuar ekzistencën e

²¹ Vendimi 7/2008, në lidhje me interpretimin e nenit 59, “Kundërshtimi i juridiksionit”, të Kodit të Procedurës Civile.

²² Vendimi i Kolegjit nr. 34, datë 6.12.2023.

²³ Vendimi i Kolegjit nr. 4, datë 15.2.2024.

²⁴ Në vendimin e Kolegjit nr. 34, datë 06.12.2023, që i përket kërkueses R. G., paragrafi 10 trajton juridiksionin e Kolegjit dhe në vendimin e Kolegjit nr. 4, datë 15.02.2024, që i përket kërkueses A. G., paragrafi 9 trajton juridiksionin e Kolegjit.

²⁵ Në të dyja këto vendime, kam dalë me mendim paralel.

- Për kërkuesen R. G., jam shprehur që kërkesa e katërt, për rishikimin e vendimit nr. 12/2019 të Kolegjit, sipas shkronjës “c” të nenit 494, është e bazuar dhe përbën shkak për rishikimin e vendimit përfundimtar.

- Për kërkuesen A. G., jam shprehur që kërkesat e saj nuk duhej t’i nënshtroheshin shqyrtimit në Kolegj pasi ato ishin paraqitur në tejkalim të afateve prekluzive ligjore.

shkaqeve për rishikim, në vlerësimin tim, përbën një ndryshim të standardit të jurisprudencës së krijuar në një qëndrim kategorik mohues që passjell cenim të parimit të sigurisë juridike.

15. Shumica e trupit gjykues në vendimin e A. Y., pasi ka deklaruar mungesën e juridiksionit rishikues, në paragrafin 16, shprehet se: [...] *trupi gjykues e sheh të nevojshme si një obiter dictum, të konfirmojë se ndonëse shkaqet e rishikimit të paraqitura prej kërkuesit A. Y. nuk i nënshtrohen juridiksionit rishikues të Kolegjit, sipas arsytimit të mësipërm, sërish ato konstatohen se janë të njëjta me shkaqet e marra në shqyrtim deri tani në jurisprudencën e Kolegjit në raste të ngjashme*²⁶ dhe do të vlerësoheshin njësoj të pabazuara edhe nëse do t'i nënshtroheshin shqyrtimit gjyqësor mbi të njëjtat argumente të përdorua në këto raste. I njëjti qëndrim mbahet edhe në këtë vendim, në paragrafin 18 të tij për kërkesën e kërkuesit Alfred Gjoni. Në vlerësimin tim, për sa kohë nga trupi gjykues është deklaruar mungesa e juridiksionit rishikues, është e panevojshme dhe pa asnjë efekt në vendimmarrje referimi në atë jurisprudencë të Kolegjit kur juridiksioni rishikues “ka funksionuar”, pasi evidenton edhe një herë sa trajtuar në paragrafin 13 të këtij mendimi paralel.
16. Në lidhje me kërkesën e kërkuesit Alfred Gjoni, paraqitur më 24.4.2023, rezulton se: (i) shkak për rishikim, sipas pretendimit të kërkuesit përbën vendimi gjyqësor i Gjykatës së Lartë, në cilësinë e “rrethanës së re” në kuptim të nenit 494, germa “a” e Kodit të Procedurës Civile, pasi përfundimisht vendosi mbi fajësinë e z. L. D. për falsifikimin e dokumenteve; (ii) kërkesa paraqitet brenda afatit 30-ditor nga marrja dijeni (20.04.2023); (iii) “prova e re” përmban të gjitha elementet e domosdoshme për vlefshmërinë e saj.
17. Sa i përket kësaj kërkeje, vlerësoj se nuk përbën shkak për rishikim dhe nuk duhet të pranohet pasi kërkesa për rishikim të një vendimi të formës së prerë sipas germës “a” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, kushtëzohet nga përmbushja e kriterit sipas të cilit *zbulohen rrethana të reja apo prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të dihen nga pala gjatë shqyrtimit të saj*. Nga leximi sistematik i germës “a” të nenit 494 të Kodit dhe në harmoni me pjesët e tjera, deduktohet që provat e rrethanat e reja që parashtrohen si shkak për rishikimin, do duhet të jenë të një natyre e cila, nëse do të njëhej prej gjykatës, do të passillte një vendim tjetër.
18. Në vlerësimin tim, vendimi gjyqësor i Gjykatës së Lartë²⁷ nuk mund të konsiderohet në cilësinë e “rrethanës së re” dhe të mundësojë rishikimin e vendimit të formës së prerë të kërkuesit, në kushtet kur nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile, në shkronjën “c”, qartazi është parashikuar një rrethanë që përbën shkak rishikimi e që lidhet drejtpërdrejt me atë që kërkuesi e pretendon si “rrethanë të re”, sipas shkronjës “a” të këtij neni.

²⁶ Vendimet e Kolegjit nr. 34, datë 06.12.2023, që i përket kërkueses R. G dhe nr. 4, datë 15.02.2024, që i përket kërkueses A. G.

²⁷ Vendimi i datës 21.03.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka lënë në fuqi vendimet e shkallës së parë dhe të apelit të Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. {***}, datë 01.12.2020, ka gjetur fajtor të pandehurin L. D., për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar në nenin 186/1 të Kodit Penal dhe ka dhënë dënimin me 6 muaj burgim. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me nr. {***}, datë 8.3.2021.

19. Neni 494 i Kodit të Procedurës Civile parashikon rregullime shumë të detajuara dhe në mënyrë shteruese për rastet e kërkesave për rishikim. Shkronja “c” e nenit 494 parashikon se: [...] *Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, kur: [...] c) palët ose përfaqësuesit e tyre apo ndonjë anëtar i trupit gjykues, që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes, kanë kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në dhënien e vendimit.* Në këtë kuptim, për sa kohë është e parashikuar qartësisht në shkronjën “c” kryerja e një veprë të dënueshme penalisht nga një anëtar i trupit gjykues, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk mund të kualifikohet si rrethanë e re nën shkronjën “a” e, për pasojë, kërkuesi i është referuar në mënyrë të gabuar kërimit të tij.
20. Parë në këndvështrimin që nëse kërkesa do të ishte paraqitur sipas shkronjës “c” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, ndaj vlerësimin tim, në koherencë me qëndrimet e mëparshme, se kërkesa do të përbënte shkak për rishikim dhe do të duhet t’i nënshtrohej shqyrtimit.
21. Sa u përket pretendimeve e parashtrimeve shtesë të depozituara nga kërkuesi lidhur me gjyqtarin A. H., ndaj vlerësim të njëjtë me trupin gjykues.

GJYQTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi